



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.05.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Enver Roshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 6 maj 2019.
2. Miratimi i kalendarit të punës së komisionit për periudhën 13 – 31 maj.

Marrin pjesë:

Enver Roshi, Klodiana Spahiu, Arben Kamami, Ilir Pendavinji, Edlira Bode, Adelina Rista, Almira Xhembulla, Klotilda Bushka, Roland Xhelilaj dhe Majlinda Halilaj.

HAPET MBLEDHJA

Enver Roshi – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Meqenëse kuorumi i nevojshëm është i plotësuar, vazhdojmë mbledhjen e komisionit. Dy anëtarë të komisionit, doktor Flamur Golemi dhe Nuri Belba, nuk janë të pranishëm, sepse kandidojnë për kryetarë bashkie, ku gjej rastin t'u uroj suksese!

Pjesëmarrës në këtë komision jemi 10 vetë dhe presim zëvendësimet nga anëtarët e tjerë deputetë.

E deklaroj mbledhjen e hapur.

Çështja e parë e rendit të ditës është miratimi i procesverbalit të datës 06.05.2019. Çështja tjetër e rendit të ditës është miratimi i kalendarit të punës së komisionit për periudhën 13-31 maj 2019. Në kalendarin e punës së Kuvendit për periudhën 13-31 maj nuk ka projektligje për shqyrtim për Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, kështu që ne presim nga anëtarët mendime dhe sugjerime, në mënyrë që të kemi një axhendë për këtë periudhë.

Ju e keni parë procesverbalin dhe mendoj se jeni të gjithë dakord.

Atëherë, miratohet procesverbali i datës 6 maj.

Dua t'ju them se kemi një kalendar për ditët ndërkombëtare të shënuara, ku Ministria e Shëndetësisë mbulon një gamë shumë të madhe. Përpara keni një përcaktim më të qartë se çfarë mbulon kjo ministri, ku përfshihen problemet e fëmijëve, të grave, të punës e të tjerë. Në këtë kontekst propozoj të kemi sugjerime nga ana juaj, në mënyrë që ne të vendosim se ku mund të shkojmë për vizita puna ose të ftojmë përfaqësues të grupeve të ndryshme. Në fakt, ne kemi pasur zonjën Olimbi, e cila ka propozuar të jetë e pranishme në komision për të raportuar, por ne dje folëm me Klodin për riformulimin edhe një herë të kërkesës së saj që të jetë e pranishme. Kështu që sapo ta sjellë kërkesën, ju mund ta njoftoni që në mbledhjet e ardhshme të mund të vij të raportojë në komision.

Mbledhja është e hapur.

Adelina Rista – Faleminderit, zoti kryetar!

Së pari, dua t'ju uroj suksese në krye të Komisionit të Shëndetësisë dhe uroj të bëjmë punë të mira së bashku për sa i përket sistemit shëndetësor!

Meqenëse jemi te miratimi i kalendarit të punës për periudhën 13-31 maj, mendoj se ashtu si shumë komisione, të cilët kanë zbritur në terren dhe po zhvillojnë seanca, edhe

komisioni ynë, Komisioni i Shëndetësisë, duhet të zbresë në terren për të parë nga afër funksionimin e sistemit shëndetësor, problematikat dhe arritjet që ka ai. Atje në bazë njihemi edhe më mirë me këto problematika.

Unë kam një propozim: të vini në Fier si komision dhe të shikoni spitalin e Fierit, investimet që janë bërë për spitalin e Fierit dhe si punohet atje. Tani po punohet te materniteti, te spitali pediatrik. Ju ftoj që të bëjmë një seancë dëgjimore në Fier dhe të inspektojmë të gjitha institucionet e shëndetësisë, që veprojnë aty, duke filluar nga Fondi i Sigurimit, nga DSHP-ja dhe spitali, pra të bëjmë një anxhendë për Fierin.

Faleminderit!

Enver Roshi – Unë di që në Fier ka edhe një projekt të HAP-it, kështu që është shumë e drejtë.

Adelina Rista – Po ta shikojmë edhe projektin e HAP-it.

Enver Roshi – Unë jam dakord. A ka ndonjë mendim?

Klodiana Spahiu – E lëmë më 17 maj, meqenëse është Dita Ndërkombëtare e Hipertensionit. Meqenëse kolegja jonë bëri këtë propozim dhe na fton që vizitën në terren ta bëjmë në Fier, mendoj se kjo është një datë e caktuar dhe mund ta realizojmë këtë gjë me një qëllim të caktuar. Përderisa ne do të bëjmë vizitë në qendrën shëndetësore, besoj se kjo shkon edhe me këtë datë, që të ketë një lloj kuptimi edhe vizita. Mendoj se me këtë tematikë do të jetë shumë mirë. 17 maj është ditë e premte.

Enver Roshi – Pasnesër.

Klodiana Spahiu – Po.

(Diskutime pa mikrofon)

Enver Roshi – Është shumë afër dhe e kemi shumë të vështirë ta realizojmë pasnesër. E bëjmë vizitën të martën, javën që vjen?

Klodiana Spahiu – Po.

(Diskutime pa mikrofon)

Edlira Bode – Unë mendoj se nuk ka nevojë të gjejmë një tematikë tjetër. Edhe pse nuk është data 17, ne mbajmë tematikën e hipertensionit, por e bëjmë vizitën të martën. Nuk është domosdoshmërisht nevoja që ne ta bëjmë fiks në atë datë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

“Hipertensioni” dhe “duhani” patjetër që mund të shkojnë bashkë. Në kuadrin e këtyre tematikave ne bëjmë vizitën, dita le të jetë e ndryshme.

Majlinda Halilaj – I uroj kryetarit, Enver Roshi, suksese në detyrën e re!

Ashtu siç foli pak më parë kolegia për spitalin Fierit, pse mos të organizojmë edhe nëpër spitale rajonale të tjera, si: Shkodër, Korçë, Dibër, Elbasan, Fier, Vlorë.

Gjithashtu, të shohim edhe spitalin tonë, pra QSUT-në, lidhur me nevojat që ka? Ndonjë sugjerim? Gjithsesi, ky është mendimi im, por besoj se edhe juaji, që t'i kontrollojmë. Ndoshta t'i shohim me radhë për nevojat që kanë, çfarë duan dhe me çfarë mund t'i ndihmojmë spitalet nëpër rrethe.

Meqenëse unë jam edhe kryetare e Përgjithshme...

Enver Roshi – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Kamami – Unë mendoj se në qoftë se do të shkojmë në QSUT, të shkojmë me një tematikë të caktuar, se nuk mund të shkojmë atje thjesht për të bërë një vizitë dhe për ta parë, sepse ne e dimë shumë mirë që të gjitha punët në QSUT janë të shpërndara në mënyrë të tillë që nuk mund të shkojmë deri te Shërbimi i Kardiologjisë, ndërkohë që mund të harrojmë këtë ose atë. Ndërsa spitalet rajonale, në përgjithësi kanë pavijone të përgjithshme, qoftë kirurgjia, qoftë patologjia, dhe atje mund të shkojmë për një problem të përgjithshëm që mund të jetë... Pra, vizitën në QSUT ta ruajmë për një ngjarje të veçantë.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Majlinda Halilaj – Faleminderit!

Unë kam sugjerime për pavijonin e fëmijëve në QSUT, sepse aty ka pasur shumë probleme: një radhë e paparë. Nuk ka shumë...

Sa më shumë doktorë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo te maternitetet, flas për te Pediatria. Aty çalojnë të gjitha, madje edhe vetë i kam hasur këto vështirësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enver Roshi – Sugjeroj që këto vizita të shoqërohen me një informacion paraprak që të dimë se çfarë të kërkojmë, pra informacion i bazuar në evidenca ose të dhëna zyrtare, sepse duhet me gjithë mend që t'u referohemi të dhënave zyrtare. Nga mediet dhe burimet e tjera marrim informacion, por shpeshherë duhen ballafaquar me të dhënat zyrtare, për të qenë korrektë edhe me punën tonë, por edhe t'u vijmë në ndihmë institucioneve shëndetësore që kemi.

Në vijim të kësaj, ndoshta për Fierin, në qoftë se do të kishim ndonjë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E saktë, të përgatitet një informacion për të gjithë situatën: numri i të shtruarve në pediatri, në maternitet, numri i lindjeve e të tjera.

Ndoshta do të lidhemi edhe me doktor Besim Nurin të HAP-it, që është atje, për të na ndihmuar. Nuk e di se si bëhet lëvizja kur shkohet nëpër rrethe: bëhet e organizuar, me makinat tona apo si? Nuk kam eksperiencë për këtë gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në qoftë se na ndihmon Kuvendi, lëvizim të organizuar. Në fakt, është më mirë të lëvizim të organizuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por të lidhemi edhe me HAP-in, me doktor Besimin, që ne po shkojmë atje, por të kemi edhe informacion për aktivitetin që kryejnë në rrethin e Fierit.

Ata kanë edhe një projekt për qarkun e Dibrës, ku përfshihet Burreli, Bulqiza...

Ju e keni të avancuar? Kështu që ndoshta në vijim të kësaj, t'u themi atyre që të na ndihmojnë. Por duam informacion të saktë edhe për t'u ardhur në ndihmë atyre për nevojat që kanë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edlira Bode – Ndoshta të martën e javës tjetër, që është data 21? Por ta lëmë një herë në parim. Pastaj, në varësi të informacionit që mund të na sjellë Adelina, ta vendosim përfundimisht.

(Diskutime në sallë)

Mund të ketë një problem, në qoftë se e lëmë kaq afër, në kuptimin e mbështetjes nga Kuvendi apo nga OSBE-ja, që na kanë mbështetur herë të tjera. Ata na kanë kërkuar që ne t'i parashikojmë lëvizjet të paktën 3 javë më parë që të na përgjigjen. Nëse e lëmë sot për javën që vjen, besoj se do të shkojmë vetë, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enver Roshi – Në vijim të kësaj unë po bisedoj edhe me HAP-in. Ndoshta ai na ndihmon për të shkuar në Fier.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – Në datën 31 është Dita Botërore kundër Duhanit. Duhet të mendojmë, se kemi 2 javë kohë për të bërë patjetër diçka: ose vizitë në Inspektoratin Shëndetësor, por duhet ta dimë që njoftimet e institucionit bëhen nëpërmjet ministrisë dhe ne këtë vështirësi e kemi pasur edhe më parë. Duhet t'i njoftojmë paraprakisht, të marrim konfirmimin nga ministria dhe më pas do të shkojmë në institucion. Nëse do ta ndajmë sot për

ta kryer, duhet që stafi i komisionit të bëjë njoftimet, sepse kjo është një procedurë, që do kohën e caktuar. Prandaj ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Data ka një lloj kuptimi, që duhet të shkohet në ditën e shënuar, se po vajtëm mëmbrapa, çfarë kuptimi ka? Ose do të shkojmë më 31, se data 30 është ditë parlamenti, se i bie e enjte. Data 31 është e premte. Nëse ne do ta bëjmë këtë lëvizje në terren për te Inspektorati Shëndetësor, ku nuk kemi shkuar ndonjëherë, duhet të njoftojmë drejtoreshën nëpërmjet ministrisë. Gjithmonë, na duhet një informacion paraprakisht, sepse me sa jam në dijeni dhe me sa keni dëgjuar edhe ju, po vijnë disa ndryshime të reja në ligjin aktual kundër duhanit. Janë propozuar disa amendime dhe do të ketë shumë debate, sepse po forcohen sanksionet për duhanpirjen dhe do të ketë rregulla më të forta penalizuese në lidhje me këtë.

Mendoj se mund ta organizojmë këtë vizitë. Sekretarja e komisionit duhet t'i çojë ministrisë kërkesën dhe të na vijë një informacion paraprakisht, siç e kërkuat ju, sepse kështu bëhet normalisht.

Për vizitat në terren për muajin qershor, nuk e di sa do t'i realizojmë, sepse e para, është fushata dhe jemi të kufizuar. Ne edhe me Rregullore nuk bëjmë dot lëvizje, sepse ato mund të quhen promovuese për fushatën. Kështu, jemi pak më të kufizuar.

Unë propozoj të jemi më të fokusuar, meqë nuk kemi projektligje, në seancën dëgjimore në lidhje me raportin e Pekinit. Ne na mblodhi ministrja dhe na tha se tashmë është depozituar raporti ynë në OKB, por ne si komision, meqenëse kjo është ministria që e mbulon komisioni, duhet të bëjmë një seancë dëgjimore në lidhje me tematika të caktuara të raportit. Mendoj se dy janë problematikat, që ne nuk i kemi pasur në fokus si komision: mosha e tretë, çfarë është bërë deri tani për moshën e tretë dhe çfarë po bëhet me avancimin e legjislacionit për këtë moshë si dhe ligji për edukimin seksual, pra “Për shëndetin riprodhues”, i cili është i vitit 2002. Pa dyshim, ne duhet të mendojmë se ky ligj, edhe në ecurinë e viteve, ka probleme dhe ka shumë gjëra të reja që duhet të diskutohen. Koha që kemi në dispozicion është e kufizuar dhe unë nuk e di se kur do ta diskutojmë këtë ligj. Ne, së bashku me të dyja këshilltaret e komisionit, duhet ta shikojmë dhe duhet ta lexojmë me shumë kujdes raportin, sepse është një raport shumë i rëndësishëm.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ju na e dërguat neve këtë raport, por, ndoshta, këshilltaret mund ta shikojnë dhe të nxjerrim problematikat kryesore. Raporti është shumë i detajuar dhe shumë i mirë, por ne duhet të fokusohemi në dy-tri gjëra. Ju vini nga një kurs, që për ne është shumë i rëndësishëm, dhe keni paraqitur një raport me të dhënat shëndetësore të vitit 2019. Kur ne miratuar në

komision një marrëveshje për huamarrjen, të cilën e kemi finalizuar, kërkuam që të kishim një seancë dëgjimore dhe një raport, që do të na i sillnin përfaqësuesit, dhe këtu janë prezentë doktor Burazeri dhe doktor Ylli.

Pra, edhe kjo gjë duhet realizuar! Në qoftë se ju kujtohet, ne kemi bërë një mbledhje gjatë kohës që zhvillohej seanca dhe u kemi lënë si detyrë përfaqësuesve që të na sillnin informacione dhe ne do të zhvillonim një seancë dëgjimore, gjë që duhet vendosur në planin e punës për t'u realizuar. Më pas do të fokusoheshim te raporti i viti 2019 në dy pika kryesore: në shëndetin seksual dhe në shëndetin riprodhues. Secili nga ne mund ta shikojë ligjin e vitit 2002 dhe mund të japim idetë tona të reja.

Unë nuk jam kundër lëvizjeve në terren, sepse edhe lëvizjet në terren janë një gjë shumë e mirë, por duhet të fokusohemi më shumë te puna parlamentare se çfarë kemi bërë deri tani.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ne mund të bëjmë edhe një takim informal më parë, sepse edhe ata e kanë në fokusin e tyre dhe duan që të propozojnë disa ndryshime, duke marrë të dhëna nga raporti i fundit i vitit 2019.

Enver Roshi – Ka një problem me raportin e ADHS-së, që është studimi i dytë demografik që është bërë në Shqipëri, sepse INSTAT-i dhe agjencia, që merrej me certifikimin e të dhënave, nuk kanë bërë zbardhjen e indikatorëve të të dhënave. Sapo ato të zbardhen, të certifikohen dhe të hidhen në internet, do të bëhen të aksesueshme. Pra, ka një vështirësi që edhe INSTAT-i, edhe shoqatat e WEN-it, që kanë ndihmuar në këtë aspekt, kanë probleme në këtë raport të ADHS-së, por të dhënat paraprake janë. Pra, ne mund t'i thërrasim ata të Institutit të Shëndetit Publik që të vijnë për të raportuar qoftë për shëndetin riprodhues, por edhe për treguesit e tjerë demografikë të vendit, siç është mosha e popullsisë shqiptare, që është një problem shumë i madh.

Klodiana Spahiu – Gjithashtu, është edhe rënia e numrit të lindjeve për tremujorin e parë. Megjithatë, tematika ka shumë, por kohën e kemi të kufizuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enver Roshi – Ne t'u japim një mundësi për në datën 29, ditën e mërkurë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndoshta të mendonim në avancë edhe për qershorin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, prandaj thashë se është në vijim të komenteve tuaja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mbledhja mbyllet.

MBYLLET MBLEDHJA